



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË DOGANËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2022

**Prishtinë, maj 2023**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Doganës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Doganës së Kosovës (DK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Doganës së Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të DK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin

e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Doganës së Kosovës.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Doganës së Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Doganës së Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Doganës së Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Doganës së Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në vitin 2022, Dogana e Kosovës ka arkëtuar rreth 11% të hyra më shumë krahasuar me vitin paraprak. Në kontekst të gjetjeve vërehet një mos harmonizim i kodeve tarifore në mes sistemit ASYCUDA dhe TARIK-ut e që për pasojë edhe zhdoganimi i mallrave të caktuara me kod tarifor jo adekuat.

Çështjet tjera të identifikuara kanë të bëjnë me vonesa në përgatitjen e planit të rekrutimit dhe mos plotësimi i pozitave menaxheriale. Po ashtu, vërehet mungesë në menaxhimin e pasurive, ku pasuritë e blera gjatë fundvitit nuk ishin regjistruar në sistemet përkatëse (SIMFK dhe e-pasuria)

Ky raport ka rezultuar me tri (3) rekomandime, prej të cilave një është rekomandim i ri dhe dy janë të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Të hyrat

Dogana e Kosovës për vitin 2022 ka realizuar të hyra neto prej 1,528,794,242€. Këto të hyra kanë të bëjnë me të hyrat tatimore (akcizë, doganë dhe TVSH), si dhe të hyrat jo tatimore (nga gjykata, tarifa tjera, nga shitja e pasurive, etj.). Krahasuar me vitin e kaluar, të hyrat bruto në përgjithësi kanë rritje. Në vitin 2022, DK kishte realizuar të hyra bruto prej 1,531,192,011€, që në krahasim me vitin 2021, të hyrat ishin 1,376,704,600€ apo rreth 11% më shumë. Kjo rritje vërehet më shumë te të hyrat nga akciza në kufi, dogana në import dhe TVSH në kufi, si rezultat i rritjes së importeve.

#### Çështja A1 - Mos harmonizimi i plotë i tarifave doganore në TARIK me sistemin ASYCUDA

**Gjetja** Neni 24 i Kodit Doganor dhe i Akcizave në Kosovë nr.03/L-109, thekson se: Detyrimet e importit për t'u paguar kur lind një borxh doganor, bazohen në nomenklaturën e mallrave të Tarifës Doganore të Kosovës, të cilat duhet të trajtohen sipas klasifikimit tarifor të këtyre mallrave përbrenda TARIK-ut.

Sistemi Asycuda nuk ishte i azhurnuar plotësisht me kodet tarifore të TARIK-ut, pasi që kishte raste kur kodet tarifore nuk përputheshin. Ne identifikuam tri (3) raste ku përcaktimi i detyrimeve doganore ishte bërë me kodin tarifor (KT-87033290-20) i cili në TARIK nuk ekziston, përderisa në sistemin Asycuda ky kod është aktiv. Përcaktimi i detyrimeve doganore në këto raste nuk kishte pasur ndonjë efekt financiar.

Dogana nuk kishte arritur të bëjë azhurnimin e listës së kodeve dhe nënkodeve tarifore në TARIK me sistemin ASYCUDA.

**Ndikimi** Mos harmonizimi i plotë i kodeve tarifave në mes TARIK me sistemin ASYCUDA, mund të ndikoj në regjistrim jo adekuat të mallrave, dhe si rrjedhojë të caktohen edhe detyrimet doganore jo përkatëse, duke e dëmtuar njërën nga palët.

**Rekomandimi A1** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete dhe me kohë për azhurnimin e plotë të kodeve tarifore në sistemin ASYCUDA, duke siguruar harmonizimin e plotë të tyre me TARIK.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 6,046,040€, ndërkaq realizimi ishte në vlerë prej 5,946,235€ apo 98%.

### Çështja B1 - Vonesa në përgatitjen e planit të rekrutimit/avansimit

#### Gjetja

Numri i stafit të aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit nr. 08/L- 066, ishte 581 punonjës, përderisa në fund të vitit ishin 524 të punësuar. Konform këtij ligji janë të planifikuar edhe pozitat në Strukturën Organizative për sistematizim të stafit. Plani për strukturën organizative ishte aprovuar në vitin 2021 me UA nr. 59/2019. Plani për rekrutim/avancim të stafit në parim hartohet/aprovohet në fillim të vitit me qëllim që i njëjti të përmbushet brenda vitit fiskal. Ne identifikuam se:

- Burimet njerëzore në gjysmën e tetorit të 2022 kishin përgatitur - Propozim planin për rekrutim/avancim të stafit doganor për vitin 2022, dhe se i njëjti ishte aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm; dhe
- Vazhdojnë të mbesin të paplotësuara 28 pozita menaxheriale edhe gjatë vitit 2022, prej tyre 13 vende mbulohen me emërim të përkohëshme, 1 me zëvendësim si dhe 14 janë të pambuluara/të lira.

Gjatë vitit, Dogana nuk kishte arritur të përfundoj asnjë proces të rekrutimit të jashtëm apo avancimit të brendshëm të stafit.

Kjo situatë qëndron për arsye se plani për rekrutim është aprovuar në tetor, dhe si rezultat në dhjetor 2022 kanë filluar procedurat e avancimit të brendshëm, por që ky proces është duke vazhduar edhe në vitin 2023.

#### Ndikimi

Mos plotësimi i pozitave të planifikuara me staf, sidomos në pozitat menaxhuese, mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e zhvillimit të aktiviteteve operationale dhe arritjen e objektivave të përcaktuara të Doganës.

#### Rekomandimi B1

Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për plotësimin e vendeve të lira të punës sipas Strukturës Organizative, duke i dhënë rëndësi të veçant pozitave menaxhuese në kuadër të organizatës. Po ashtu, plani për rekrutim dhe avancim të stafit duhet të përgatitet paraprakisht për vitin vijues, në mënyrë që të realizohet gjatë vitit përkatës.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



### 2.1.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 3,857,425€, pasurive jokapitale është 168,551€, si dhe e stokeve 171,785€.

#### Çështja B2 - Nënvlërësim i pasurisë jo financiare

##### Gjetja

Sipas nenit 6 pikave 1 dhe 3 të rregullores MF nr.02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jofinanciare përcaktojnë që “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Po ashtu, neni 2 thekson se të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Nga testimet e regjistrin të pasurive kemi identifikuar se pasuritë e DK ishin të nënvlerësuara për 92,967€. Informatat detaje janë si në vijim:

- Pasuritë kapitale dhe jokapitale të blera nga ana e DK-së në vlerë prej 83,296€ nuk ishin evidentuar në regjistrat përkatës të pasurive (si pajisje për laborator, pajisje për përcaktimin e pikës së ndezjes, licenca, investime në vijim, etj.); dhe
- DK në PFV nuk kishte shpalosur vlerën e pasurive nën 1,000€ të blera deri në vitin 2018 të cilat vazhdon të mbajë të regjistruara në sistemin Inventory, vlera e mbetur e të cilave ishte 9,671€.

Mos regjistrimi i plotë i pasurive ka ndodhur pasi që zyrtari i pasurisë, për shkakë shëndetësore gjatë vitit 2022 ka qenë në pushim mjekësor dhe nuk ka mundur të angazhohet fare. Përderisa, mos prezantimi i pasurive nën 1,000€ të cilat mbahen ende në sistemin e DK - Inventory ishte me arsyetimin se kishte probleme me sistemin i cili nuk ka arritur të mënjanohet.

##### Ndikimi

Mos regjistrimi i plotë i pasurisë si dhe mos funksionimi i sistemit vështirëson menaxhimin dhe kontrollin e pasurive në dispozicion, dhe rrit rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të pasurive. Gjithashtu kjo ndikon që informatat e prezantuara në PFV, të jenë jo të plota dhe jo të sakta.

##### Rekomandimi B2

Drejtori i Përgjithshëm duhet të ndërmerri veprime konkrete në kohën e duhur për angazhimin e stafit për të mbuluar pozita e lira në mënyrë që të mos shkaktohen pengesa në operim gjatë evidentimit të pasurive. Po ashtu, të funksionalizoj sistemin Inventory nën 1,000€ që të bëjë migrimin e pasurive në sistemin e-pasuria.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>7</sup>	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>11,520,664</b>	<b>10,438,958</b>	<b>8,994,904</b>	<b>8,362,746</b>	<b>8,754,823</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	11,520,664	10,438,958	8,994,904	8,362,746	8,677,987
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	76,836

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 1,081,706€. Kjo ulje është si rezultat i reduktimit të buxhetit me rishikim dhe ndryshimeve buxhetore me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2022 DK ka shpenzuar 86% të buxhetit përfundimtar ose 8,994,904€ me një rritje prej 1% në krahasim me vitin 2021. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>11,520,664</b>	<b>10,438,958</b>	<b>8,994,904</b>	<b>8,362,746</b>	<b>8,754,823</b>
Pagat dhe mëditjet	6,046,040	6,046,040	5,946,235	5,815,101	5,933,072
Mallrat dhe shërbimet	2,505,249	2,527,691	2,216,651	1,977,692	1,686,590
Komunalitë	269,375	119,375	68,001	60,602	93,795
Investimet Kapitale	2,700,000	1,745,852	764,017	509,352	1,041,367

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Realizimi i buxhetit final në kategorinë e pagave dhe mëditjeve është 98%. Nuk kishte pasur ndryshim të buxhetit fillestar me atë final për këtë kategori;
- Buxheti final për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve (përfshirë komunalitë) në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 127,558€, ndërsa realizimi i tij ishte 86%. Në qershor, DK kishte bërë kërkesë në MFPT për transferin e mjeteve në vlerë prej 122,441€ nga kategoria e Investimeve Kapitale në Mallra dhe Shërbime për shpenzime të banderolave. Si rrjedhojë, buxheti (M&SH pa Komunali) ishte rritur për këtë vlerë. Përkundër kësaj rritje, në fund të vitit me vendimin e Qeverisë të datës 12/12/2022, është bërë shkurtim i buxhetit nga kjo kategori për 100,000€. Përdërisa Komunalitë me rishikim

të buxhetit janë zvogëluar në vlerë prej 150,000€; dhe

- Buxheti final për kategorinë e investimeve kapitale ishte më i ulët se ai fillestar për 954,148€. Në këtë ka ndikuar transferi prej 127,558€ në mallra dhe shërbime si dhe reduktimet e buxhetit bazuar në vendimet e Qeverisë të datave 09 nëntor, 13 dhe 29 dhjetor 2022, përkundër zvogëlimit të buxhetit, realizimi ishte i ulët me vetëm 44%.

Niveli i ulët (44%) i shpenzimeve nga kategoria e Investimeve kapitale është ndikuar nga ankesat në Organin Shqyrtues të Prokurimit nga ofertuesit për njërin projekt, vonesat në nënshkrimin e katër kontratave nga Ministri si dhe ndryshimi i vendimit nga Qeveria për delegimin e zhvillimit të procedurave për pajisje me vetura nga vetë DK. Këta faktorë kanë ndikuar që 6 nga 12 projektet e planifikuara të mos realizohen fare.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat doganore të planifikuara nga Qeveria e Kosovës me Ligjin nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2022 ishin 1,440,240,000€. Ndërkaq, me Ligjin e rishikuar të buxhetit nr. 08/L-143, vlera e parashikuar e të hyrave doganore ishte rritur në 1,477,770,000€. Nga kjo vlerë, DK kishte arritur të realizonte 1,531,192,011€, ndërsa në vlera neto, realizimi ishte 1,528,794,242€, apo 103% e planifikimit (të hyrat bruto 1,531,192,011€ -2,397,769€ kthimet).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Të hyrat bruto	1,440,240,000	1,477,770,000	1,531,192,011	1,376,704,600	1,052,525,263
Kthimet	-5,730,000	-5,730,000	-2,397,769	-2,841,906	-1,655,371
<b>Të hyrat neto</b>	<b>1,434,510,000</b>	<b>1,472,040,000</b>	<b>1,528,794,242</b>	<b>1,373,862,694</b>	<b>1,050,869,892</b>

**Tabela 4. Të hyrat/pranimet e realizuara dhe kthimet sipas kategorive ekonomike në tri vitet e fundit (në €)**

Përshkrimi	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
AKCIZA NË KUFİ	517,264,274	501,257,845	397,791,382
AKCIZA E BRENDSHME	0	37,231	280,768
DOGANA NE IMPORT	132,663,255	124,606,455	101,618,260
MASË MBROJTËSE ANTIDAMPING	262,177	116,904	980,311
TVSH NË KUFİ - DOGANA	875,383,036	746,548,380	547,645,723
TATIMET TAKSA TJERA NGA DOGANA	50,588	448,395	1,919,426
KUNDËRVAJTJE E DËNIMEVE DOGANORE	1,267,312	816,605	479,218
TË HYRAT NGA GJYKATA - TË PASPECIFIKUAR	16,769	34,871	32,417
TË HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE	378,430	258,081	215,971
BANDEROLAT	547,057	468,600	359,538
PRANIMET NGA TARIFAT PËR VENDIMET GJYQËSORE/PËRMBARIMORE	41,926	66,029	42,601
TË HYRAT PAS ZHDOGANIMIT	3,317,187	2,045,204	1,159,649
<b>Totali i pranimeve bruto</b>	<b>1,531,192,011</b>	<b>1,376,704,600</b>	<b>1,052,525,263</b>
KTHIMI I AKCIZËS	-695,525	-1,157,985	-464,254
KTHIMI I TAKSAVE DOGANORE	-445,603	-333,775	-362,885
KTHIMI I TVSH - DOGANA	-966,206	-798,841	-792,839
KTHIMI - TATIMET TAKSA TJERA NGA DOGANA	-290,435	-551,305	-35,394
<b>Gjithsej shuma e kthimeve</b>	<b>-2,397,769</b>	<b>-2,841,906</b>	<b>-1,655,371</b>
<b>Totali i pranimeve neto (bruto- kthimet)</b>	<b>1,528,794,242</b>	<b>1,373,862,694</b>	<b>1,050,869,892</b>

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2021 të DK-së ka rezultuar me dy rekomandime kryesore. DK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022 dy rekomandimet janë të përsëritura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Tabela 5 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për aprovimin e Udhëzimeve përkatëse dhe plotësimin e vendeve të lira të punës sipas Strukturës Organizative, duke i dhënë rëndësi të veçantë pozitive menaxhuese në kuadër të organizatës.	Edhe pse DK kishte ndërmarrë masa për t'a adresuar këtë çështje, duke shpallur konkursin për avancim të brendshëm në muajin dhjetor 2022, ky konkurs nuk ishte arritur të përfundoj brenda këtij viti. Prandaj, kjo çështje ende mbetet e pa zbatuar. Si rezultat, për vitin 2022 janë 28 pozita menaxhuese të pambluara (prej tyre: 13- me emërime të përkoshme; 1- me zëvendësues dhe 14- të lira, të pa mbuluara).	Nuk është adresuar
2.	Pasuritë	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë nën 1000€ regjistrohen në sistemin e-Pasuria dhe të ketë një menaxhim efektiv të pasurive të amortizuara - jashtë përdorimit në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.	DK nuk kishte integruar të gjitha pasuritë nën 1000 në sistemin e-pasuria, por kishte formuar komisionin e inventarizimit dhe kishte kryer inventarizimin e pasurive.	Nuk është adresuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndhimëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Edona Abazi, Udhëheqëse e ekipit



Arta Kryeziu, Anëtare e ekipit



Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Doganës së Kosovës**, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Agron Llugajli  
Drejtor i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës  
Data: 26 Prill 2023



Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi Nr. 1, 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel & Fax + 383 (0) 38 540 350 / +383 (0) 38 540 836  
[www.dogana-ks.org](http://www.dogana-ks.org)

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>9</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>9</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinion i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.



## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

### Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> ASYCUDA është Softuer i cili përdoret nga Dogana e Kosovës për gjenerimin e të hyrave
- <sup>6</sup> TARIK është tarifa e integruar e kodeve doganore të Kosovës
- <sup>7</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>8</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>9</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.